

**Konferenca Kombëtare e Financave të Klimës –
Shqipëri**
**MOBILIZIMI I FINANCEVE TË KLIMËS: gatishmëria
kombëtare, reformat dhe hapat e radhës**

Kontekst

Shqipëria ka nevojë të përshpejtojë kalimin nga angazhimet strategjike për klimën drejt zbatimit në terren, duke mobilizuar financa të klimës në shkallë më të gjerë. Konferenca Kombëtare e Financave të Klimës u konceptua si një platformë kombëtare dialogu për të bërë “bilancin” e gatishmërisë së vendit, për të identifikuar pengesat dhe boshllëqet aktuale, dhe për të ndërtuar një momentum të përbashkët për koordinimin e investimeve dhe partneriteteve afatgjata.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm është të forcohet gatishmëria e Shqipërisë për mobilizimin e financave të klimës, përmes dialogut të strukturuar ndër-institucional dhe me partnerët e zhvillimit.

Objektivat specifike përfshijnë:

- Të paraqitet gjendja dhe praktikrat e mira të financave të klimës në Shqipëri dhe nevoja në nivel qendror e vendor.
- Të diskutohen barrierat, boshllëqet dhe mundësitë për mobilizim pas CoP30, përfshirë rolin e sektorit bankar dhe privat.
- Të paraqiten koncepte projektsh investimi (p.sh. Kontrata Vendore e Klimës e Bashkisë Elbasan dhe projekte nga NAP).
- Të ngrihet baza për një platformë kombëtare të financave të klimës dhe një pipeline projektsh të bankueshme.

Komponentët kryesorë dhe rezultatet

- Pjesa I – Përgatitja strategjike: qeverisja e klimës, stabiliteti ekonomik dhe koordinimi i programimit/ndihmës.
- Pjesa II – Reforma dhe arritje: kuadri rregullator i energjisë dhe kuadri i financave të qëndrueshme (përfshirë gatishmërinë e sektorit bankar dhe referencën ndaj taksonomisë së BE-së).
- Pjesa III – Panel ekspertësh: dialog teknik mbi instrumentet e financave të klimës, mekanizmat e zbatimit, M&V/M&E, rolin e sektorit privat/bankar dhe bashkëpunimin rajonal.
- Produkt kryesor pas-konferencës: Letra e Angazhimit (Pledge) e Qeverisë së Shqipërisë dhe thirrja për angazhim reciprok të partnerëve, si dhe nisja e një dialogu të strukturuar pas-konference.



**INFORMACION I
PËRGJITHSHËM**

INSTITUCION THIRRËS:
Ministria e Mjedisit, Shqipëri

MBËSHTETJE:
UNESCO
Urban Research Institute

DATA
15 Dhjetor 2025

KONTAKT:
Zana Vokopola, Drejtore
Ekzekutive
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rruga e Barrikadave,
Pall 14 K, Kati 4, Ap. 44,
Tiranë 1057
T: +355694333808
E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU-t

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.